



Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

**RAPORT SPECIAL
PËR NDIKIMIN
E COVID-19**

NË SUNDIMIN E LIGJIT NË KOSOVË

**Vlerësim dhe rekomandime
për periudhën mars 2020 – mars 2021**

Maj 2021



Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

**Raport special
për ndikimin e COVID-19
në sundimin e ligjit në Kosovë**

**Vlerësim dhe rekomandime për periudhën
mars 2020 – mars 2021**

Maj 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
VLERËSIMI I ASPEKTEVE TË PËRZGJEDHURA NË SISTEMIN E DREJTËSISË	7
Identifikimi i rasteve urgjente	11
Publiciteti i seancave dëgjimore	11
Përputhshmëria me protokollet COVID-19: sigurimi i publicitetit dhe siguria e gjyqimeve	14
Përdorimi i video-telekonferencave (VTC).....	15
Aplikimi i “rregullit të tre muajve”	16
VLERËSIMI I ÇËSHTJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SISTEMIN KORREKTUES	17
Zbatimi i masave për parandalimin e COVID-19 në institucionet korrektuese të Kosovës	18
Ndërprerja e vizitave familjare.....	20
Pezullimi i përkohshëm i punës jashtë institucioneve	23
Qasja e Avokatit të Popullit në institucionet korrektuese	23
Qasja e avokatëve në institucionet korrektuese	24
Lirimi i të burgosurve të cënueshëm nga institucionet korrektuese.....	25
SHTOJCË – REKOMANDIME	26

PARATHËNIE

Ndërsa ka kaluar më shumë se një vit me pandeminë COVID-19, u pa si kohë e duhur për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) që ta bëjë një hap prapa dhe ta vlerësojë gjendjen në fushat e sundimit të ligjit në Kosovë për të cilat ai e ka mandatin t'i monitorojë dhe ndihmojë: sistemin e drejtësisë dhe shërbimin korrektues.

Si kudo tjetër, institucionet e sundimit të ligjit të Kosovës gjatë vitit të kaluar e gjetën veten duke lundruar në ujëra të panjohura më parë, shpesh të ballafaquara me vendime të vështira dhe urgjente, duke u përpjekur të vendosnin një ekuilibër midis drejtësisë dhe zbatimit të ligjit nga njëra anë dhe shëndetit dhe sigurisë publike në anën tjetër.

Si e caktoni përparësinë e rasteve gjyqësore kur për arsye të shëndetit publik mbajtja qoftë edhe e ndonjë seance gjyqësore bëhet shumë e rrezikshme? A ekziston ndonjë mënyrë për ta siguruar qasjen e publikut dhe medias në një gjykim në mes të një pandemie pa e kthyer atë në një "superpërhapës"? Cila është mënyra më e arsyeshme për ta garantuar mirëqenien psikologjike dhe sociale të një të burgosuri duke i mbajtur në fuqi kufizimet e nevojshme për ta parandaluar përhapjen e virusit?


Këta janë disa nga skenarët e jetës reale si pasojë e COVID-19 për të cilët partnerët tanë të sundimit të ligjit në Kosovë është dashur të gjejnë përgjigje gjatë vitit të kaluar. Kurse ekspertët e EULEX-it kanë qëndruar pranë tyre gjatë gjithë kësaj krize dhe janë përpjekur që t'i ndihmojnë autoritetet e Kosovës duke e monitoruar situatën, e cila shpesh herë ishte e paparashikueshme dhe ndryshonte me shpejtësi, si dhe duke ofruar këshilla për mënyrën se si të reagojnë dhe të përshtaten me sfidat e shkaktuara nga pandemia.

Ky raport i identifikon këto sfida dhe ofron një analizë të thellë të çështjeve kryesore që janë paraqitur dhe mësimet të nxjerra. Ai gjithashtu ofron rekomandime konkrete dhe të realizueshme për sistemin e sundimit të ligjit të Kosovës për t'ju përgjigjur më mirë krizës së vazhdueshme shëndetësore.

Ndërsa përqendrohet në çështje të ndërlidhura me pandeminë, ky raport ndjek gjurmët e raportit më të gjerë të EULEX-it të publikuar në fund të vitit të kaluar mbi monitorimin tonë të thelluar sistematik dhe tematik të drejtësisë penale dhe civile të Kosovës. Një draft fillestar i këtij raporti tashmë është ndarë me institucionet në Kosovë që janë përgjegjëse për gjyqësorin dhe shërbimet korrektuese. Kurse me anë të këtij botimi ai është bërë i disponueshëm edhe për aktorët e shoqërisë civile që kanë interes aktiv në sundimin e ligjit, për mediat, si dhe për qytetarët e Kosovës në përgjithësi.

Në fund, ky raport është një dëshmi e përkushtimit, profesionalizmit dhe qëndrueshmërisë së shumë hetuesve policorë, gjyqtarëve, prokurorëve, oficerëve korrektues dhe personelit tjetër të sundimit të ligjit në Kosovë që kanë punuar pa pushim gjatë gjithë pandemisë për t'i shërbyer drejtësisë në rrethana të vështira.

Lars-Gunnar Wigemark
Shef i Misionit



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pandemia COVID-19 ka paraqitur sfida të papara ndonjëherë për institucionet e sundimit të ligjit në mbarë botën, përfshirë edhe në Kosovë. Shumë prej pengesave që kanë rrjedhur nga pandemia vazhdojnë të kenë ndikim mbi funksionimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe tani ato janë pjesë e realitetit të ri ndaj të cilave autoritetet në Kosovë dhe gjëkund duhet të reagojnë në periudhë afatshkurtë si dhe afatgjatë. Derisa institucionet duhet që gjithnjë të angazhohen që ta garantojnë të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndet, ato njëkohësisht duhet, po ashtu, të baraspeshojnë ndikimin e masave kufizuese mbi të drejtat e tjera të njeriut dhe sundimin e ligjit në përgjithësi.

Në këtë raport paraqitet vlerësimi i menaxhimit të pandemisë në aspekte të caktuara të drejtësisë dhe të sistemit korrektues në Kosovë. Ky raport nuk është raport gjithpërfshirës dhe nuk i mbulon të gjitha aspektet e sundimit të ligjit të cilat janë prekur nga pandemia, por përqëndrohet në fushat në të cilat EULEX-i ka mandat mirë të konsoliduar dhe përvojë të drejtpërdrejtë. Megjithatë, këtu mund të nxirren konkluzione të caktuara të përgjithshme, të cilat mund të vlejnë edhe për fusha të tjera të sundimit të ligjit.

Kosova fillimisht i bazoi masat e saja parandaluese në legjislacionin ekzistues. Në gusht 2020, Kuvendi i Kosovës e miratoi "*Ligjin për parandalimin dhe luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës*". Megjithatë, ky ligj kryesisht e trajton kufizimin e lirisë së lëvizjes dhe nuk i adreson sfidat e hasura nga sistemi i drejtësisë dhe sistemi korrektues. Pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të drejtësisë dhe atyre korrektuese për adresimin e problemeve që ndodhin në mungesë të legjislacionit specifik, EULEX-i vlerëson se mungesa e bazës juridike të qartë për disa prej masave që tashmë janë ndërmarrë duhet të adresohet me urgjencë me qëllim të shmangies së pasigurisë juridike në të ardhmen. Kjo është thelbësore për të siguruar që Kosova i mbështetë parimet themelore të sundimit të ligjit, siç janë ligjshmëria, procesi i drejtë dhe siguria juridike, si dhe që të fuqizohen transparenca dhe besimi në institucionet e drejtësisë dhe të shërbimit korrektues.

Me ndërprerjen e aktiviteteve gjyqësore për shkak të masave të mbylljes kundër COVID-19 në mes të muajit mars dhe qershor 2020, ai që quhet rregull i tre muajve i paraparë në Kodin aktual të Procedurës Penale dhe i cili parasheh se gjykimet penale duhet të rifillojnë nëse për tre muaj rresht nuk mbahet asnjë seancë dëgjimore, u bë i aplikueshëm pothuaj në të gjitha rastet penale që ishin në fazë të gjyimit në Kosovë. Në shumicën e rasteve penale të monitoruara nga EULEX-i, gjykatat janë bazuar në një praktikë gjyqësore për të siguruar përshtatshmërinë e gjyimit duke i lexuar të gjitha deklaratat e mëparshme në dosje. Megjithatë, fakti se kjo praktikë nuk është e lejuar në mënyrë shprehimore me ligj krijon pasiguri juridike dhe duhet të adresohet në mënyrë urgjente, mundësisht përmes veprimeve legjislative.

Për më shumë, çështjet praktike si përdorimi i video-telekonferencave (VTC) gjatë gjytimeve, duhet të rregullohet në mënyrën e duhur me ligj. Për të siguruar përputhshmërinë me standardet për të drejtat e njeriut, kufizimet për qasje në institucionet korrektuese, në veçanti vizitat familjare, duhet të parashihen qartë në legjislacionin përkatës, t'i plotësojnë kriteret e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit si dhe të jenë të ndjeshme ndaj aspektit gjinor. Autoritetet, po ashtu, duhet ta shqyrtojnë miratimin e legjislacionit, atëherë kur të jetë e sigurtë të bëhet kjo gjë, për shtyrjen, pezullimin, apo ndërprerjen e dënimeve për shkak të arsyeve që

ndërlidhen me pandeminë, në veçanti për grupet e cenueshme, siç janë të miturit dhe personat e rrezikuar nga zhvillimi i simptomave të rënda të COVID-19.

Për më tepër, meqë pandemia vazhdon të shpaloset, është gjithashtu esenciale që të gjitha autoritetet përkatëse të drejtësisë dhe ato korrektuese të bëhen shembull dhe të sigurojnë përputhshmëri me masat e parandalimit të COVID-19, në veçanti në objektet e gjykatave dhe në institucionet korrektuese.

Tashmë një vit me pandeminë, drejtësia dhe shërbimet korrektuese të Kosovës, si dhe qeveria e sapozgjedhur dhe Kuvendi i Kosovës, duhet ta shfrytëzojnë mundësinë për ta shqyrtuar se si është menaxhuar kriza deri më tani dhe t'i shohin mësimet e nxjerra. Autoritetet duhet ta vlerësojnë ndikimin negativ të masave parandaluese, në veçanti në lidhje me grupet e cenueshme, si për shembull, viktimat e dhunës në baza gjinore, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe ekonomitë familjare të varfëra.

VLERËSIMI I ASPEKTEVE TË PËRZGJEDHURA NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 i detyroi shumë shtete anëtare të BE-së që ta përshtasin funksionimin e sistemeve gjyqësore të tyre me rrethanat e reja me qëllim të sigurimit të përmbushjes së të drejtës për shëndet dhe mbrojtjes së të drejtës për jetë. Varësisht prej sistemeve juridike të tyre, kjo u bë në mënyra të ndryshme: përmes miratimit të ligjeve të reja apo amendamentimit të ligjeve ekzistuese, përmes shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme apo nxjerrjes së dekreteve përkatëse, apo duke u dhënë kompetencë autoriteteve gjyqësore apo ministrive të drejtësisë për të ndërmarrë masa në lidhje me pandeminë.

Në Kosovë, autoritetet fillimisht zbatuan masa parandaluese ndaj COVID-19 për të gjitha institucionet publike, përfshirë edhe gjykatat, përmes aplikimit të legjislacionit ekzistues, dhe në veçanti "*Ligjit nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse dhe Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetin*".¹ Më vonë, në gusht 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi një ligj specifik, përkatësisht "*Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës*".² Megjithatë, ndonëse iniciativë për t'u përgëzuar kjo, e domosdoshme dhe e ndërmarrë me kohë, ky ligj vetëm e siguron një bazë juridike për kufizimin proporcional, të domosdoshëm dhe legjitim të lirisë së lëvizjes dhe nuk i adreson shumë prej çështjeve juridike që ngriten nga pandemia.

Derisa disa prej masave që i përkasin funksionimit të sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale janë vendosur në bazë të ligjeve të lartcekura, masat më relevante janë vendosur jashtë fushëveprimit të këtyre ligjeve përmes vendimeve të veçanta të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK).

Më 12 mars 2020, KGJK nxori vendimin 52/2020.³ Në pajtim me këtë vendim dhe në bazë të vlerësimit të kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve të rasteve, shumica e veprimtarive gjyqësore që kanë përfshirë praninë e publikut janë kufizuar përkohësisht, dhe qasja e publikut në objektet e gjykatave po ashtu u kufizua. Më 15 mars 2020, KGJK nxori vendimin 53/2020⁴ përmes së cilit urdhëroi zvogëlimin domethënës të veprimtarive të KGJK dhe gjykatave, dhe e kufizoi punën e gjykatave ekskluzivisht për *veprimtaritë e natyrës urgjente*.

1 Më 11 mars 2020, pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19 në Kosovë, autoritetet pezulluan procesin arsimor si dhe linjat e udhëtimit me shtetet me rrezik të lartë dhe kufizuan aktivitetet publike dhe ato të gastronomisë. Më 12 mars 2020, Qeveria themeloi një komision special për menaxhimin e parandalimit të infektiveve dhe më 13 mars 2020 ajo ndaloi hyrjen dhe daljen nëpër disa komuna. Qeveria i mbylli kufijtë dhe gastronominë dhe i reduktoi aktivitetet publike dhe private vetëm me pjesëmarrës esencial. Më 15 mars 2020, qeveria shpalli gjendje emergjente të shëndetit publik. Më 23 mars 2020, me vendim nr. 01/15, qeveria kufizoi lirinë e lëvizjes së të gjithë personave dhe lejoi aktivitetet në hapësira të jashtme për vetëm tetë orë në ditë. Përgjatë kësaj ka patur për nevoja mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale, dhe për shërbime që ndërlihdeshin me menaxhimin e pandemisë.

2 Ligji nr. 07/L-006 për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës (25.08.2020) <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=30819>

3 Vendimi KGJ nr. 52/2020, 12 mars 2020, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/13755_Vendimi_Nr_52_2020_Kufizohen_perkohesisht_veprimtarit_gjyqesore.pdf.

4 Vendimi KPK nr. 53/2020, 15 mars 2020, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/63168_Vendimi_KGJK-se_Nr.53_2020_per_Masat_parandalimit_infekcionit_nga_Corona_Virusi_SHQ.pdf

Më 14 mars 2020, KPK miratoi një vendim⁵ për zvogëlimin domethënës të veprimtarive të këtij organi dhe atyre të Zyrës së Prokurorit të Shtetit. Në pajtim me atë vendim, Kryeprokurori i Shtetit dhe Kryeprokurorët u udhëzuan që të caktonin prokurorë kujdestarë dhe staf administrativ të mjaftueshëm vetëm për kryerjen e veprimtarive të natyrës urgjente dhe veprimtarive të tjera të caktuara në pajtim me afatet ligjore. Për shembull, në muajt e parë të pandemisë (mars deri maj 2020), Prokuroria Speciale e Kosovës (PSRK) kryesisht ka trajtuar kërkesat për fillimin apo zgjatjen e hetimeve për dyshimet për raste të rënda, kërkesat për zgjatjen apo zëvendësimin e paraburgimeve, kërkesat për zgjatjen e masave ndaluese më të lehta (p.sh. arrestet shtëpiake, paraqitjet në polici), dhe kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare për raste urgjente.

Pothuajse dy muaj më vonë, pas përmirësimit të përkohshëm të situatës epidemiologjike, më 8 maj 2020, KGJK përmes Vendimit 83/2020⁶ vendosi të ngrisë nivelin e veprimtarive të KGJK dhe të gjykatave duke i autorizuar ato që të vazhdojnë me kryerjen e veprimtarive të natyrës urgjente, dhe të rifillojnë veprimtari të tjera në të cilat “prania e palëve dhe e publikut nuk kërkohet në procedurë” (pika 3 e Vendimit 83/2020).

Më 29 maj 2020, KGJK miratoi Vendimin 85/2020⁷ i cili solli rifillimin e menjëhershëm të veprimtarive të KGJK dhe të gjykatave në pajtueshmëri me masat për parandalimin e COVID-19. Me anë të këtij vendimi, gjyqtarëve iu kërkua që të fillonin punën me rastet në pajtim me prioritetet juridike dhe modalitetet e përcaktuara nga KGJK. Vendimi përcaktoi, për shembull, se seancat gjyqësore duhej të mbaheshin pa praninë e publikut. Vendimi 85/2020 është ende në fuqi.

Në po të njëjtën ditë, KPK miratoi Vendimin nr. 244/2020⁸ i cili krijoi bazën për shtimin e veprimtarive edhe të KPK dhe të Prokurorit të Shtetit. Me anë të këtij vendimi KPK përcaktoi: 1) të rriteshin veprimtaritë e punës të KPK dhe të Prokurorit të Shtetit; 2) që Kryeprokurorët e Prokurorive të jenë të autorizuar që t’i bashkërendojnë veprimtaritë për një kthim të shtuar të prokurorëve në zyra dhe që stafi administrativ të kryejë veprimtari prokuroriale; 3) që Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK dhe Drejtori i Njësisë për vlerësimin e performancës prokuroriale të autorizohen t’i bashkërendojnë veprimtaritë për kthimin e shtuar të zyrtarëve në zyra në kuadër të Sekretariatit, Njësisë dhe Prokurorisë së Shtetit; dhe 4) që kthimi i plotë në punë i të gjithë punonjësve duhet të bëhet në bashkërendim me institucionet e shëndetit publik në Kosovë.

5 Vendimi KPK Nr. ___/2020 [Vendimi nuk ka titull], 14 mars 2020, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Vendime/Vendim%20-%20Reduktohen%20esencialisht%20aktivitetet%20n%C3%AB%20kuad%C3%ABr%20t%C3%AB%20K%C3%ABshillit%20Prokurorial%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs%20dhe%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>

6 Vendimi KPK nr. 83/2020, 8 maj 2020, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/57454_Vendimi_KGJK_Nr_83_2020_Shtohet_aktiviteti_punes_se_Keshillit_Gjyqesor_te_Kosoves_dhe_te_gjitha_Gjykatat_vendit..pdf

7 Vendimi KPK nr. 85/2020, 29 maj 2020, https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/90277_KGJK_Vendimi_Nr_85_2020_Rifillon_puna_ne_KGJK_dhe_ne_gjykatat_RKS-se.pdf

8 Vendimi KPK nr. 244/2020, 29 maj 2020, <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Vendime/Vendim%20Nr.462.2020%20-%20Shtohen%20aktivitetet%20e%20pun%C3%ABs%20n%C3%AB%20sistemin%20prokurorial.pdf> [shqip]; <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Vendime/Odluka%20Br.462.2020%20-%20Povecavaju%20se%20aktivnosti.pdf> [serbisht].

Më tej, më 29 maj 2020, KGJK ashtu edhe KPK miratuan plane të veprimit për menaxhimin e krizës (më tej në tekst: planet e KGJK dhe KPK për krizën).⁹

Plani i KPK për krizën i përcakton parimet e trajtimit të krizës dhe hapat që duhet ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes së sistemit prokurorial. Plani ka tre elemente thelbësore: a) krijimin e ekipeve qendrore dhe rajonale për menaxhimin e krizës; b) mbrojtjen e shërbimeve jetike dhe proceseve të punës dhe c) fuqizimin e komunikimit dhe bashkërendimit. Plani i KPK për krizën nuk parasheh asnjë udhëzim juridik për: prioritizimin e rasteve/rasteve urgjente, trajtimin e hetimeve, pezullimin e mundshëm të hetimeve dhe çështjet e tjera juridike të ndërlidhura të krijuara nga pandemia. Autorizimi për trajtimin e krizës dhe për nxjerrjen e vendimeve juridike qëndron tek ekipet qendrore dhe rajonale për menaxhimin e krizës.

Në maj të vitit 2020, KPK publikoi *Udhërrëfyesin e përkohshëm për mbrojtje nga COVID -19 në Sistemin Prokurorial të Kosovës*,¹⁰ me udhëzime rreth protokolleve për mbrojtje dhe shëndet.

Plani i KGJK për krizën themelon organe në nivel qendror (KGJK) dhe lokal (gjykata) të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e krizës, në tri faza të operimit.

Faza 1 (mbyllje e plotë): mbahen vetëm rastet urgjente, përfshirë rastet të cilat mund të arrijnë parashkrimin, si dhe veprimtaritë e tjera të identifikuar si esenciale; gjykatat mbyllën për punë me palë, përveç për rastet urgjente të cekura më sipër; aty ku përmbushen kushtet teknike, seancat dëgjimore mund të mbahen përmes video apo telekonferencës (VTC); kryetarët e gjykatave, me pajtimin e KGJK, mund të vendosin të mbajnë seanca dëgjimore në objekte të tjera nëse gjykata nuk është e qasshme, e sigurtë apo nuk ka hapësirë të mjaftueshme; të gjitha rastet urgjente duhet të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme; varësisht prej rrethanave, duhet të shqyrtohet mundësia e mbajtjes së seancave dëgjimore përmes VTC apo thirrjeve telefonike, pa praninë e palëve dhe pjesëtarëve të tjerë të publikut. Nëse asnjë prej opsioneve të sipërme nuk është i mundur, atëherë seancat dëgjimore do të mbahen në sallën e gjykimit, duke i respektuar masat për parandalimin e COVID-19. Gjykata siguron që seancat dëgjimore përmes VTC të regjistrohen.

Faza 2 (masat e moderuara): Gjatë kësaj faze masat kufizuese rishikohen dhe puna me përfshirjen e palëve rifillon gradualisht. Në bashkërendim me KGJK, kryetarët e gjykatave vendosin individualisht për ngritjen ose jo të numrit të shërbimeve. Gjykatat vazhdojnë të mbajnë seanca dëgjimore VTC aty ku është e mundur. Kur kjo nuk është e mundur, seancat dëgjimore mbahen nëpër salla të gjykimit. Në këto raste, të gjitha protokollat duhet të respektohen, përfshirë për kufizimin e qasjes së publikut në gjykatë. Prania e qytetarëve është e kufizuar dhe duhet të bazohet në ftesat e gjykatës apo në praninë e një marrëveshjeje paraprahe. Qytetarëve iu kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë me anë të cilës deklarojnë

9 Vendimi KGJK nr 86/2020, 29 maj 2020 plani i veprimit për menaxhimin e krizës https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/69352_KGJK_Plani_veprimit_per_menaxhimin_krizes.pdf; SHQIP https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/48851_KGJK_Plani_veprimit_per_menaxhimin_krizes_SRB.pdf; ALB <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/Plani%20i%20Veprimit%20p%C3%ABr%20Menaxhimin%20e%20Kriz%C3%ABs.pdf>; SRB: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Plane%20te%20Punes/Akcion%20Plan%20o%20Upravljanju%20Krize.pdf>

10 Këshilli Prokurorial i Kosovës, udhëzues i përkohshëm për mbrojtje nga COVID-19 në sistemin prokurorial të Kosovës maj 2020 <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/Provisional%20guide%20for%20protection%20by%20Covid19%20in%20the%20Kosovo%20prosecutorial%20system.pdf>

se ata nuk kanë pasur kontakt me persona të infektuar; distanca fizike duhet të sigurohet; palëve iu ndalohet hyrja në gjykatë pa maska; sallat e gjykimeve duhet të riorganizohen dhe të shënjoen për mbajtjen e distancës fizike; numri i palëve që mund të hyjnë në gjykatë është i kufizuar.

Faza 3 (funksionimi i gjyqësorit me kujdes të shtuar): Kjo i referohet fazës ku liria e lëvizjes së qytetarëve nuk është e kufizuar, por rreziku nga infektimi nuk ka kaluar plotësisht dhe kujdesi i shtuar ende kërkohet. Gjatë kësaj faze i tërë stafi kthehet në punë. Gjyqësori kthehet në kapacitetin e tij të plotë, duke hartuar strategji për trajtimin e rasteve që nuk kanë mundur të shqyrtohen gjatë dy fazave fillestare. Seancat dëgjimore përmes VTC vazhdojnë aty ku është e mundur, ndërsa seancat dëgjimore në salla të gjykimeve mbahen me kujdes të shtuar si në dy fazat e mëparshme. Në bazë të rekomandimeve të institucioneve përkatëse, hapësirës në dispozicion dhe kushteve të tjera përkatëse, gjykatat vendosin vet për numrin e personave që u lejohej të jenë të pranishëm nëpër seanca/salla të gjykimeve. Gjykatat po ashtu duhet të sigurojnë zbatimin e protokolleve për mbrojtje përfshirë (mes të tjerash): përmes kufizimit të pranisë së qytetarëve nëpër gjykata në bazë të ftesave të gjykatës apo pranisë së një marrëveshjeje paraprake; duke iu kërkuar qytetarëve që të nënshkruajnë një deklaratë që konfirmojnë se ata nuk kanë pasur kontakt me persona të infektuar; përmes sigurimit të distancës fizike; përmes ndalimit të hyrjes së palëve në gjykatë pa maskë; përmes riorganizimit dhe shënjitimit të sallave të gjykimeve për mbajtjen e distancës fizike; përmes kufizimit të numrit të palëve që mund të hyjnë në gjykatë, dhe përmes mënyrave të tjera sanitare dhe higjienike.

KGJK ka vepruar në pajtueshmëri me vendimet dhe rekomandimet e nxjerra nga qeveria dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Ato rekomandime kanë qenë të vlefshme për një periudhë dyjavore dhe janë rishikuar në mënyrë periodike. Qeveria e Kosovës i ka kategorizuar të gjitha komunat në tri grupe sipas shkallës së rrezikut nga infektimet me COVID-19 (pra, me rrezik të ulët, rrezik të mesëm, dhe rrezik të lartë). Rekomandimet për ndërmarrjen e veprimeve konkrete prej institucioneve publike bëheshin varësisht prej këtij kategorizimi.

Për këtë qëllim, duke pasur parasysh se situata me pandeminë nëpër Kosovë dallonte me kalimin e kohës (secila komunë kishte numër të ndryshëm të infektimeve dhe kështu nivel të ndryshëm të rrezikut), KGJK vendosi që vëllimi i punës së gjykatave të organizohej në bashkëpunim me kryetarët përkatës të gjykatave. Në pajtim me kategorizimin periodik të rrezikut të secilit rajon të Kosovës (i ulët, i mesëm apo i lartë), funksionimi i gjykatave përkatëse u organizua në pajtim me rekomandimet e dhëna nga IKSHPK për secilat komuna sipas grupeve të rrezikut. KGJK i udhëzoi kryetarët e tjerë të gjykatave që të zbatojnë planin e veprimit për menaxhimin e krizës në pajtim me rekomandimet e dhëna nga IKSHPK. Secila gjykatë duhej t'i zbatonte veprimtaritë dhe masat e parapara për secilën fazë të punëve (mbyllje e plotë, masa të moderuara, dhe kujdesi i shtuar) sipas planit të KGJK që korrespondon me nivelin e rrezikut të zonës ku gjendet secila gjykatë.

Pjesët e raportit në vijim paraqesin një vlerësim të disa prej masave më të rëndësishme që janë shpjeguar më sipër për nga aspekti i standardeve të zbatueshme për të drejtat e njeriut, si dhe disa rekomandime për institucionet relevante.

Identifikimi i rasteve urgjente

Si edhe në të gjitha shtetet të cilat kanë zgjedhur zvogëlimin domethënës të punës së institucioneve publike për ta kufizuar përhapjen e virusit, në mesin e muajit mars 2020 vendosja e masës së mbylljes në Kosovë e ngriti pyetjen se cilat veprimtari të gjykatave mund të pezulloheshin dhe se cilat duhej të vazhdonin me qëllim të shmangies së dëmeve të pariparueshme.

Më 15 mars 2020, me anë të Vendimit 53/2020, KGJK i përkufizoi veprimtaritë/rastet e natyrës urgjente si: *‘masat për të siguruar praninë e të pandehurve në procedura penale – masat e paraburgimit apo të tjera, rastet e dhunës në familje, masat e tjera, si dhe rastet e tjera urgjente të cilat mund të paraqiteshin eventualisht (pika II e vendimit).*

Në qershor 2020, pas miratimit nga KGJK të ‘Planit të krizës’ të cekur më sipër, rastet me rrezikun e pashmangshëm të parashkrimit, po ashtu, u përfshinë në mesin e veprimtarive të vlerësuara si ‘urgjente’.

Në përgjithësi, identifikimi i veprimtarive urgjente nga KGJK ishte bërë sipas praktikave më të mira të miratuara në shumë shtete evropiane.¹¹ Disa prej këtyre shteteve kanë përfshirë në mesin e veprimtarive të vlerësuara si ‘urgjente’ edhe procedurat e iniciuara për kundërshtimin e sanksioneve për shkeljet e rregullave të mbylljes. Kjo kategori e procedurave nuk është e përfshirë në mënyrë shprehimore në mesin e ‘veprimtarive urgjente’ në Kosovë. Megjithatë, formulimi i pikës II të Vendimit 53/2020 ua beson gjykatave në Kosovë një shkallë të diskrecionit për identifikimin e ‘veprimtarive urgjente’, përveç atyre që janë të përfshira shprehimisht.

Rekomandim:

- Qasja e miratuar nga KGJK për identifikimin e një numri të veprimtarive specifike të vlerësuara si ‘urgjente’ por, që në të njëjtën kohë, gjyqtarëve ua lë një shkallë të diskrecionit për përcaktimin e veprimtarive të tjera urgjente është për t’u përgëzuar. EULEX-i i inkurajon gjykatat që ta përdorin këtë diskrecion me maturi dhe në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të prioritizohen aktivitetet të cilat, nëse do të neglizhoheshin, do të shkaktonin dëme të pariparueshme, në veçanti ndaj individëve apo grupeve të cënueshme;

Publiciteti i seancave dëgjimore

Në mbarë botën pandemia ka krijuar sfida të rënda në aspektin e mbrojtjes së të drejtës për gjykim të drejtë, dhe në veçanti të natyrës publike të seancave.

Publiciteti i seancave dëgjimore është komponent thelbësor i të drejtës për gjykim të drejtë, e drejtë kjo e cila në sistemin juridik të Kosovës njihet në mënyrë solide përmes dispozitave specifike në Kushtetutën e Kosovës, në veçanti: neni 31 (E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm) dhe neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare). Neni 22 përcakton zbatim të drejtpërdrejtë të të drejtave që parashihen, në mes të tjerave, në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP), të cilat përmbajnë dispozita për të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht nën nenin 6 dhe nenin 14.¹²Në pajtim me dispozitat

11 Shih disa shembuj: ‘OSCE Primer Functioning of Courts in the COVID-19 pandemic/OSBE Primer Funkcionimi i gjykatave gjatë pandemisë COVID-19’ në faqen <https://www.osce.org/odihr/469170>

12 Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson në paragrafin e parë: “Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë të ketë seanca dëgjimore të drejta dhe publike brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj.

e lartcekura, kriteri për mbajtjen e seancës dëgjimore publike i nënshtrohet përjashtimeve të kufizuara, përkatësisht: *rendit publik, sigurisë kombëtare, interesave të miturve apo privatësisë së palëve në procedurë dhe parimeve etike.*

Në Kosovë, publiciteti i seancave dëgjimore më tej përshkruhet me nenin 293¹³ të Kodit të Procedurës Penale (KPP).¹⁴ Neni 294 i KPP, në anën tjetër, i specifikon rrethanat që mund të shtyjnë gjykatën që ta përjashtojë publikun, nëse një gjë e tillë vlerësohet si e nevojshme, me kërkesë të palëve apo sipas detyrës zyrtare.¹⁵

Sipas së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të vendit e cila zbatohet në Kosovë, nuk ekziston ndonjë dispozitë specifike e cila do ta autorizonte gjykatën për ta përjashtuar publikun nga seancat dëgjimore në rast të ndonjë emergjence të shëndetit publik, siç është ndonjë pandemi. Andaj, ndalimi i plotë i qasjes së publikut në salla të gjykimeve për shkak të COVID-19 mund të konsiderohet si shkelje esenciale e së drejtës procedurale dhe në fund mund të shpije në anulimin e aktgjykimit (neni 384 KPP).

Ndonëse Vendimi i KGJK 85/2020, i datës 29 maj 2020, në thelb thekson se seancat dëgjimore publike pa praninë e publikut lejohen, Plani i KGJK për Krizën sqaroi se, në të gjitha fazat, gjykatat do të vazhdojnë të mbajnë seanca përmes VTC, aty ku është e mundur, dhe aty ku nuk është e mundur seancat dëgjimore do të mbahen në salla të gjykimeve në pajtim me protokollin COVID-19 dhe me kufizim të qasjes së publikut në gjykata. Sipas Planit për krizën, prania e qytetarëve në objekte të gjykatave është e kufizuar, duke u bazuar në ftesat nga gjykata apo praninë e një marrëveshje paraprake.

Aktgjykimi shpallet publikisht por mediat dhe publiku mund të përjashtohen gjatë tërë gjykimit apo gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces, ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata në rrethana të veçanta kur publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë". Ngjashëm, Neni 14 i MNDCP, paragrafi një thekson: "[...] Mediat dhe publiku mund të përjashtohen gjatë tërë gjykimit apo gjatë një pjese të tij për arsye të moralit, rendit publik (ordere public) apo sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, apo kur interesi i jetës private të palëve e kërkon një gjë e tillë, apo deri në shkallën që çmohet tepër e nevojshme sipas opinionit të gjykatës në rrethana të veçanta ku publiciteti do të paragjykonte interesat e drejtësisë; por çdo aktgjykim i dhënë në rastet penale apo për ndonjë padi në gjyq bëhet publik përveç kur interesi i personave të mitur e kërkon ndryshe apo kur procedura ka të bëjë me kontestet martesore apo kujdestarinë e fëmijëve."

Komenti i përgjithshëm nr. 32 për nenin 14 të MNDCP të Komisionit të OKB për të Drejtat e Njeriut e sqaron rëndësinë e publicitetit të seancave dëgjimore me vërejtjet si në vijim: "Të gjitha gjykimet për raste penale apo që kanë të bëjnë me paditë në gjyq duhet në parim të mbahen verbalisht dhe publikisht. Publiciteti i seancave dëgjimore siguron transparencën e procedurës dhe kështu jep siguri të rëndësishme për interesin e individit dhe shoqërisë në përgjithësi [...]".

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në jurisprudencën e saj ka theksuar se "[...] mbajtja publike e seancave dëgjimore në gjykatë përbën parim themelor të ruajtur në paragrafin 1 të nenit 6. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të fshehtë të drejtësisë pa patur shqyrtim nga publiku; ai po ashtu edhe një prej mjeteve për ruajtjen e besimit në gjykata. Përmes administrimit transparent të drejtësisë, publiciteti kontribuon në përmbushjen e qëllimit të nenit 6 § 1, përkatësisht gjykimin të drejtë, garantimi i të cilit është një prej parimeve themelore të çdo shoqërie demokratike'

13 Neni 293 KPP: Publiciteti i shqyrtimit gjyqësor 1. Shqyrtimi gjyqësor është i hapur. 2. Në shqyrtim gjyqësor mund të marrin pjesë personat madhor. 3. Personat e pranishëm në shqyrtim gjyqësor nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin të cilët janë të autorizuar nga gjyqtari i vetëm, kryetari i trupit gjykues apo kryetari i gjykatës.

14 KPP 04/L-123, 13 dhjetor 2012: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2861>

15 Neni 294 KPP: Përjashtimi i publikut 1. Nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me propozimin e palëve ose sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre, mund të përjashtojë publikun gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ose nga një pjesë e tij, kur kjo është e nevojshme për: 1.1. ruajtjen e fshehtësisë zyrtare; 1.2. ruajtjen e informacionit të fshehtë i cili do të rrezikohet nga shqyrtimi i hapur; 1.3. ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit; 1.4. mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë; 1.5. mbrojtjen e interesave të fëmijëve; ose 1.6. mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve bashkëpunues dhe dëshmitarëve, siç parashihet në Kapitullin XIII të këtij Kodi.

Në bazë të nenit 293 të KPP, shqyrtimi kryesor mbahet në gjykim të hapur. Në pjesën hyrëse të procesverbalit të shqyrtimit kryesor, në mes të tjerave, gjykata është e obliguar që të tregojë nëse shqyrtimi kryesor ka qenë i hapur apo nëse publiku është përjashtuar (neni 318 KPP). Publiku mund të përjashtohet për arsyet e dhëna në nenin 294 të KPP. Përjashtimi i publikut nuk zbatohet ndaj: palëve, mbrojtjes, palëve të dëmtuara dhe përfaqësuesve të tyre, përveç me kusht të mbrojtjes së palëve të dëmtuara/dëshmitarëve. Gjyqtari mund të jep leje për kategori të caktuara si: zyrtarë, akademikë, figura publike dhe, me kërkesë të akuzuarit, edhe bashkëshortin-bashkëshorten/partnerin-partneren dhe familjarët e ngushtë të tij/saj për të vijuar gjykimin i cili nuk është i hapur për publikun (Neni 295 KPP). Gjyqtari (ose trupi gjykues) është i obliguar që të nxjerr aktvendim të arsyetuar për përjashtimin e publikut. Ai aktvendim mund të ankimohet vetëm përmes ankesës kundër aktgjykimit. Nëse gjyqtari (ose trupi gjykues) nuk jep aktvendim për përjashtim, kjo përbën shkelje thelbësore të KPP, çka përbën bazë të ligjshme për ankimimin e aktgjykimit.

Përgjatë periudhës e cila mbulohet me këtë raport, monitoruesit e EULEX-it dhe monitoruesit e tjerë të gjykatave janë lejuar rregullisht që të marrin pjesë nëpër seanca dëgjimore, edhe nëse ato ishin të mbyllura për publikun, qoftë për shkak të pandemisë apo arsyeve të tjera të parapara me KPP. Ka pasur raste ku gjyqtarët kryesues u kanë kërkuar OJQ-ve që i monitoronin seancat dëgjimore që ta reduktonin numrin e përfaqësuesve të tyre nëpër salla të gjykimeve (p.sh. numrin e praktikantëve të pranishëm) me qëllim të respektimit të rregulloreve për distancë fizike gjatë pandemisë. Gjithashtu, ka pasur raste, në veçanti gjatë periudhës së mbylljes nga marsi deri në qershor 2020, kur pjesëtarë të publikut (përfshirë familjarët) nuk janë lejuar që të jenë të pranishëm për shkak të kufizimeve COVID-19. Megjithatë, që nga zbatimi i Planit të KGJK për Krizën dhe rihapjes së gjykatave në fillim të qershorit 2020, në EULEX nuk ka ardhur asnjë ankesë nga publiku për sa i përket refuzimit të hyrjes nëpër salla të gjykimit gjatë seancave. EULEX-i, po ashtu, nuk ka vërejtur ndonjë problem madhor apo praktikë të përsëritur sa i përket përjashtimit konstant të publikut nga gjykimet. EULEX-i ka vërejtur, gjithashtu, prani të gjerë dhe të papenguar të mediave brenda sallave të gjykimeve në seanca dëgjimore të profilit të lartë dhe në raste të tjera që tërheqin interesimin e publikut.

Megjithatë, ka pasur raste kur prania e shtuar e publikut ka rezultuar me salla të tejmbushura ku ishte e pamundur të zbatoheshin protokollat apo masat për ndalimin e përhapjes së COVID-19.

Rekomandime:

- Me qëllim të sigurimit të respektimit të parimit të 'publicitetit', gjykatat duhet të vazhdojnë të sigurojnë objekte të përshtatshme për praninë e publikut të interesuar. Derisa masat për kufizimin e numrit të personave që fizikisht janë të pranishëm në sallë të gjykimit mund të vlerësohen të domosdoshme dhe proporcionale për parandalimin e përhapjes së virusit, është e rëndësishme që këto dispozita të mos interpretohen në atë mënyrë që për të gjitha arsyet praktike të ndalojnë publicitetin e gjykimeve;
- Kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët duhet të bëjnë aranzhime dhe të bëjnë plane më të mira paraprake për shfrytëzimin sa më të mirë të objekteve të gjykatave dhe sallave të gjykimeve, në veçanti për shmangien e përdorimit të sallave të vogla për gjykime me numër të madh të pjesëmarrësve dhe përdorimit të sallave të mëdha për gjykime me më pak pjesëmarrës;
- Kryetarët e trupave gjykues duhet të sigurojnë në mënyrë proaktive që publiku të lejohet të vijojë seanca dëgjimore dhe njëkohësisht të sigurojnë respektimin e distancës fizike dhe të masave mbrojtëse;

- Nëse ngritet nevoja për kufizimin e pranisë së publikut nëpër sallat e gjykimit, duke i pasur parasysh kufizimet COVID-19, kryetarët e trupave gjykues megjithatë duhet të sigurojnë që publiku që dëshiron të vijon seanca dëgjimore në kapacitetin e tyre privat të mos ndalohen në mënyrë automatike.

Përputhshmëria me protokollet COVID-19: sigurimi i publicitetit dhe siguria e gjykimeve

Në pajtim me Planin e KGJK për Krizën, i miratuar në qershor 2020, përhapja e virusit COVID-19 nëpër objektet e gjykatave, përfshirë nëpër sallat e gjykimeve, duhet të parandalohet përmes kufizimit të qasjes së publikut siç është shpjeguar më sipër, si dhe përmes zbatimit të masave shtesë. Qytetarëve u kërkohet që të nënshkruajnë një deklaratë për të konfirmuar se ata nuk kanë pasur kontakt me persona të infektuar; distanca fizike duhet të respektohet; hyrja në objekte të gjykatave pa maska është e ndaluar; sallat e gjykimeve duhet të riorganizohen përfshirë për sa i përket rregullimit të ulëseve, kurse duhet mbajtur distanca fizike.

Monitorimi i rasteve nga ana e EULEX-it me prani fizike nëpër salla të gjykimeve në mbarë Kosovën gjatë periudhës prej 3 qershor deri 13 korrik 2020 dhe prej 12 tetor 2020 deri 10 janar 2021, si dhe prej 25 janar 2021 e tutje, ka zbuluar një praktikë shqetësuese të mospërfilljes së protokolleve për parandalimin e COVID-19.

Informatat e përgjithshme rreth rregullave që publiku duhet t'i respektojë gjatë qëndrimit brenda objekteve të gjykatave janë dukur të pamjaftueshme, dhe numri i dezinfektuesve të shpërndarë nëpër objektet e gjykatave po ashtu nuk ka qenë i mjaftueshëm. EULEX-i nuk ka vërejtur shpërndarje të maskave apo fletushkave nga personeli i gjykatave për publikun dhe ka vërejtur se një numër i konsiderueshëm i publikut nuk ka vënë maska apo nuk i kanë vënë ato në mënyrën e duhur. Gjithashtu, EULEX-i nuk ka vërejtur asnjë prej pjesëtarëve të publikut të jetë kërkuar që të nënshkruaj deklaratën për të konfirmuar se ata nuk kanë pasur kontakt me persona të infektuar.

Gjatë seancave, EULEX-i ka vërejtur se disa trupa gjykues apo gjyqtarë të vetëm janë përpjekur që ta shpërndajnë publikun brenda sallave të gjykimit, për të mundësuar distancimin e sigurtë. Megjithatë, sapo dilnin jashtë objekteve të gjykatave, njerëzit kishin tendencë të grumbulloheshin dhe t'i ulnin apo hiqnin maskat. Po ashtu, nuk ka pasur pauza gjatë procedurave për ta mundësuar ajrosjen e sallave të gjykimit dhe as ajrosje të duhur të tyre gjatë seancave.

Moszbatimi i protokolleve bëhet veçanërisht problematik në rastet me numër të madh të të pandehurve. EULEX-i ka vërejtur se kur seancat janë mbajtur nëpër salla më të mëdha distanca mes palëve ka mund të ruhet relativisht më lehtë, ndonëse ka pasur shumë raste ku trupat gjykues nuk i kanë paralajmëruar palët për ruajtjen e distancës. Gjendja ishte më e komplikuar kur caktoheshin seanca në salla më të vogla pavarësisht numrit të madh të të pandehurve, duke e bërë kështu distancimin fizik të pamundur. EULEX-i po ashtu ka vërejtur se në rastet me të pandehur të profilit të lartë, kryetarët e trupave gjykues janë dukur se kanë ngurruar që t'u kërkojnë të pranishmëve të bartnin maska apo edhe nuk e kanë bërë fare atë kërkesë. Megjithatë, duhet të theksohet se të gjithë të pandehurve në paraburgim u kanë siguruar maska gjatë seancave.

Seancat gjyqësore shpesh kanë filluar më vonë nga sa ishin caktuar, çka e ka shtuar kohën që palët dhe publiku e kanë kaluar nëpër objekte të gjykatave. Planifikimi i përdorimit të sallave të gjykimeve po ashtu nuk ka qenë adekuat në shumë gjykata. EULEX-i ka vërejtur procedura

me një të pandehur e të cilat ishin organizuar në salla të mëdha, ndërsa raste me nga 15 të pandehur të caktuara nëpër salla më të vogla.

Fatkeqësisht, edhe anëtarët e trupave gjykues kanë qenë jokonsistent apo më pak rigoroz për sa i përket mënyrës së bartjes së maskave në gjykata.

Rekomandime:

- Gjyqtarët dhe stafi i gjykatave duhet të kërkojnë dhe të sigurojnë përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës fizike, në veçanti brenda sallave të gjykimit;
- Sallat e gjykimit duhet të ajrosen shpesh;
- Shenjat për masat mbrojtëse duhet të jenë të dukshme dhe dezinfektuesit për duar të jenë gjithmonë në dispozicion brenda objekteve të gjykatave;
- Caktimi i sallave duhet të bëhet sipas numrit të personave që priten të jenë të pranishëm në gjykime (të pandehurit, avokatët, dëshmitarët, palët e dëmtuara, publiku, etj.);
- Stafi i gjykatës duhet t'i informojë palët dhe publikun në mënyrë proaktive në për kohën realisht të pritshme të fillimit të seancave dhe të parandalojnë qasjen nëpër zonat e pritjes deri në kohën e fillimit të seancave dhe/apo praninë e panevojshme në objektet e gjykatave.

Përdorimi i video-telekonferencave (VTC)

Në Evropë, autoritetet në shumë shtete e përdorin metodën VTC për mbajtjen e seancave nga largësia. Zgjedhja e këtij lloji të seancave në njërën anë varet nga ekzistimi i bazës juridike që e mundëson atë, dhe në anën tjetër nga disponueshmëria e mjeteve teknologjike të nevojshme.

Aktualisht, KPP e lejon në mënyrë specifike mbajtjen e VTC gjatë seancave, në rastet e Mundësive Hetimore të Veçanta (Neni 149 i KPP) dhe në rastet kur urdhërohen masa të mbrojtjes (Neni 222, para. 1.3 i KPP). Përveç kësaj, KPP mundëson dorëzimin e dokumenteve në regjistrat e gjykatave përmes mënyrave elektronike (Neni 442 KPP). Megjithatë, KPP nuk e autorizon mbajtjen e VTC për seancat për paraburgim, ndonëse Plani i KGJK për Krizën e pandemisë e lejon mbajtjen e VTC në *raste urgjente*. Në bazë të monitorimeve nga EULEX, si dhe bisedave të bëra me disa kryetarë të gjykatave, gjykatat kryesisht kanë kufizuar përdorimin e seancave online për raste civile, ndërsa ato kanë ngurruar t'i përdorin mjetet për VTC në rastet penale për shkak të mungesës së mjeteve teknologjike si dhe për shkak të shqetësimeve në lidhje me privatësinë apo integritetin e seancave online (p.sh. mundësia e ndërhyrjeve) si dhe administrimit të provave në seancat online.

Rekomandime:

- Përdorimi i VTC duhet të rregullohet në mënyrën e duhur me ligj;
- Ndonëse nuk është e parashikuar në mënyrë specifike në KPP, prania e publikut po ashtu mund të sigurohet përmes mjeteve teknologjike. Kjo mund të zbatohet përmes dhënies së vegëzës/linkut për video për publikun dhe mediat, apo përmes sigurimit të monitorëve televiziv në hapësira të ndara në salla të gjykimit. Në mungesë të një rregulloreje konkrete për këtë çështje, është e këshillueshme që kjo çështje të rregullohet me ligj.

Aplikimi i “rregullit të tre muajve”

Standardet për të drejtat e njeriut të zbatueshme për sistemin e drejtësisë penale kërkojnë prej autoriteteve, mes tjerash, që të sigurojnë të drejtën për gjykim të drejtë, të drejtën për kontroll gjyqësor mbi çdo privim të lirisë, dhe të drejtën për mjete juridike efektive.

Me qëllim të vazhdimin të përmbushjes së funksioneve kyçe që dalin prej këtyre obligimeve gjatë periudhave të mbylljeve të plota apo të pjesshme të institucioneve, shumë shtete në Evropë dhe gjëkund i kanë pezulluar apo zgjatur afatet procedurale dhe i kanë udhëzuar gjykatat që të prioritizojnë raste të caktuara. Autoritetet e Kosovës kanë identifikuar *veprimtari urgjente* siç është shpjeguar më sipër, por nuk kanë adresuar në mënyrë të menjëhershme një sërë çështjesh të ngritura nga afatet procedurale në vazhdim.

Gjatë periudhës së mbylljes institucionale për shkak të COVID-19 nga 14 mars deri 1 qershor 2020, EULEX-i ka vërejtur se çështjet e ngritura nga aplikimi i të ashtuquajturës ‘rregullit të tre muajve’ nuk janë adresuar, ndonëse çështja është ngritur vazhdimisht nëpër takime me Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe me zyrtarë të lartë të qeverisë që nga fundi i muajit prill 2020.

Sipas Nenit 311, para. 3 dhe Nenit 312, para.3 të KPP: “[...], shqyrtimi kryesor rifillon nga fillimi dhe të gjitha provat shqyrtohen prapë nëse shqyrtimi kryesor është shtyrë për më shumë se tre (3) muaj.”

Megjithatë, nga monitorimi i bërë prej EULEX-it është parë se në shumicën e rasteve kjo dispozitë nuk ka pasur ndikim në rrjedhën e procedurës për shkak të një praktike gjyqësore të zakonshme: në seancën e parë të gjykimit pas tre muajve të mungesës së aktivitetit, palët mund të dakordohen që të gjitha provat e paraqitura në seancat e mëparshme të konsiderohen si ‘të lexuara’ duke e përfshirë gjithashtu një përshkrim përkatës në procesverbalin e gjykimit. Megjithatë, KPP nuk e lejon këtë praktikë në mënyrë shprehimore. Andaj, gjithnjë ekziston mundësia që aktgjykimet të ankimohen në një fazë të mëvonshme të procedurës me arsyetimin e bazës procedurale.

Rekomandim:

- Çështja e “rregullit të tre muajve” duhet të rregullohet urgjentisht me ligj me qëllim të sigurimit të sigurisë juridike. Vlen të theksohet se drafti aktual i KPP parasheh se në vend të tre muajve, do të duhet të kalojnë gjashtë muaj mes dy seancave dëgjimore para rifillimit të gjykimit. Me rëndësi, ai po ashtu e lejon në mënyrë specifike vlerësimin e dëshmive si të lexuara pas kalimit të këtyre gjashtë muajve çka do të kontribuonte në siguri juridike të shtuar.

VLERËSIMI I ÇËSHTJEVE TË PËRZGJEDHURA NË SISTEMIN KORREKTUES

Në kontekstin e pandemisë COVID-19, cenueshmëria specifike e personave të mbyllur nëpër institucione korrektuese është identifikuar në një fazë të hershme si çështje për t'u trajtuar me urgjencë nga autoritetet përkatëse të Kosovës. Siç është theksuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në mars të vitit 2020 *“Personat e privuar nga liria, si personat nëpër burgje dhe vende të tjera të ndalimit, kanë mundësi të jenë më të rrezikuar nga shpërthimi i sëmundjes së koronavirusit (COVID-19) sesa popullata e përgjithshme për shkak të kushteve të mbyllura në të cilat ata jetojnë së bashku për periudha kohore të zgjatura”*.¹⁶ Një faktor tjetër që duhet të merret parasysh është se të burgosurit janë në përgjithësi më pak të shëndetshëm krahasuar me popullatën e përgjithshme, çka mund të rezultojë me komplikime më të rënda në rast se ata infektohen me virusin.

Sipas të drejtës ndërkombëtare dhe asaj të Kosovës, autoritetet kanë për detyrë të ndërmarrin hapa për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave të privuar nga liria. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në mënyrë specifike ka vendosur se autoritetet kanë obligim pozitiv për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse për personat e privuar nga liria. Rregullat Evropiane për Burgjet të Këshillit të Evropës, të cilat përmbajnë standarde dhe parime juridike thelbësore për menaxhimin e burgjeve, theksojnë se *“autoritetet e burgjeve do ta ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë nën përkujdesjen e tyre”* (Rregulli 39). Këto obligime në anën e autoriteteve rrjedhin nga fakti se të burgosurit vetëm mund të mbështeten tek këto autoritete për ta përmirësuar dhe mbrojtur shëndetin e tyre andaj ky obligim i përkujdesit është i rëndësishëm së madhe.¹⁷

Në fazat e hershme të shpërthimit të pandemisë, më 20 mars 2020 Komisioni i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) nxori *Deklaratën e parimeve në lidhje me trajtimin e personave të privuar nga liria në kontekstin e pandemisë së sëmundjes së koronavirusit (COVID-19)* (më tej në tekst: Parimet e KPT).¹⁸ Parimet konfirmojnë domosdoshmërinë e luftimit të COVID-19 në vendet e privimit të lirisë, dhe njëkohësisht ua përkujtojnë autoriteteve se masat parandaluese asnjëherë nuk duhet të rezultojnë në trajtim apo dënim çnjerëzor apo degradues.

Thelbi i detyrës së vështirë për gjetjen e ekuilibrit të cilën autoritetet janë të thirrura ta kryejnë më së miri ilustronet përmes leximit të kombinuar të Parimeve 1 dhe 4 të KPT, të cilat theksojnë se: *“Parimi themelor duhet të jetë ndërmarrja e të gjitha veprimeve të mundshme për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së të gjithë personave të privuar nga liria. Ndërmarrja e këtyre veprimeve i kontribuon edhe ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë së stafit.”* (Parimi 1 i KPT) dhe se: *“Çfarëdo mase kufizuese e ndërmarrë kundrejt personave të privuar nga liria për parandalimin e përhapjes së COVID-19 duhet të ketë bazë ligjore dhe të jetë e domosdoshme, proporcionale, dhe*

16 OBSH, Gatishmëria, parandalimi dhe kontrolli i COVID-19 në burgje dhe vende të tjera të ndalimit, udhëzimi i përkohshëm 15 mars 2020, p. 2.

17 Rregullat evropiane për burgjet, Rregulli 39: Autoritetet e burgjeve ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë nën përkujdesjen e tyre. Rregulli 40.2 Politikat shëndetësore në burgje integrohen në politikën kombëtare për shëndetin dhe janë kompatible me të. Rregulli 40.3 Të burgosurit kanë qasje në shërbimet shëndetësore që i ofron shteti pa diskriminim në bazë të gjendjes së tyre juridike. Rregulli 40.4 Shërbimet mjekësore në burgje kërkojnë zbulimin dhe trajtimin e sëmundjeve apo defekteve fizike apo mendore prej të cilave mund të vuajnë të burgosurit.

18 Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin apo Dënimin Çnjerëzor apo Degradues: <https://rm.coe.int/16809cfa4b>

duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe të jetë e kufizuar në kohë. Personat e privuar nga liria duhet të marrin informata të plota rreth atyre masave në gjuhën që e kuptojnë.” (Parimi 4 i KPT)

Parimet e KPT japin kornizë të dobishme për vlerësimin e efektivitetit të përgjigjeve të Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) dhe të autoriteteve të tjera përkatëse ndaj pandemisë si dhe respektimit të standardeve të drejtave të njeriut nga ana e tyre.

Siç është theksuar nga KPT, shqiptimi i masave parandaluese gjithnjë duhet të baraspeshohet kundrejt të drejtave të tjera dhe asnjëherë nuk duhet të rezultojë në shtypjen e paligjshme apo joproporcionale të këtyre të drejtave.

Në pjesët në vazhdim do të paraqitet vlerësimi i efektivitetit të masave parandaluese të ndërmarra nga SHKK dhe ndikimit të pandemisë mbi çështjet siç janë vizitat familjare, qasja e Avokatit të Popullit dhe qasja në avokat si dhe çështje të tjera.

Zbatimi i masave për parandalimin e COVID-19 në institucionet korrektuese të Kosovës

Autoritetet e Kosovës qysh herët e panë nevojën për përgatitje për parandalimin e ndonjë shpërthimi të pandemisë nëpër institucionet korrektuese. Konsultimet lidhur me masat e nevojshme për t’u ndërmarrë ishin duke u zhvilluar ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë (MD), SHKK dhe Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) qysh në janar dhe shkurt 2020, të nxitura nga numri në rritje i rasteve me COVID-19 gjithandej nëpër botë. Më 11 mars 2020, në ditën kur masat e miratuara nga Qeveria e Kosovës hynë në fuqi, SHKK në bashkëpunim me Departamentin e MSH për Kujdesin Shëndetësor nëpër Burgje dhe me MD, e miratuan Planin Operacional (PO) i titulluar ‘*Plani Operacional – Rritja e masave të sigurisë për shkak të përhapjes së koronavirusit apo në rast të ndonjë rasti të raportuar të infektimit*’.¹⁹

PO ia beson përgjegjësinë për zbatimin e masave menaxhmentit të institucioneve të ndryshme korrektuese. Masat e miratuara ishin shumë të ndryshme për nga natyra dhe shtriheshin nga shtimi i standardeve të higjienës nëpër objekte dhe shpeshësisë së kontrolleve shëndetësore për të burgosurit dhe stafin, deri tek pezullimi i vizitave të familjarëve dhe krijimit të hapësirave për karantinimin e të burgosurve që ktheheshin prej objekteve të gjykatave apo vizitave spitalore.²⁰ Me vendimin e 13 marsit 2020, puna e të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese poashtu u pezullua.

19 Më 11 mars 2020, numri i personave në burgje ishte 1755 (1282 të dënuar dhe 473 të paraburgosur) prej të cilëve 42 ishin në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan dhe 44+16 (44 të mitur të dënuar, të paraburgosur apo në masa edukative dhe 16 të burgosur të moshës madhore) ishin në Qendrën Korrektuese në Lipjan. Sipas të dhënave më datë 31 dhjetor 2020, numri i personave në burgje ishte 1398 (1014 të dënuar dhe 384 të paraburgosur) prej të cilëve 35 ishin në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan dhe 39+9 (39 të mitur të dënuar, të paraburgosur apo nën masat edukative dhe 15 të burgosur të moshës madhore) ishin në Qendrën Korrektuese në Lipjan (burimi: PO).

20 Masat e parapara në PO ishin: Ndalimi i vizitave familjare për të burgosurit nga data 12 mars deri 27 mars 2020; mundësia për më shumë thirrje telefonike për të burgosurit; instalimi i komunikimit me Skype në institucionet korrektuese; pezullimi i përkohshëm i pushimeve gjatë fundjavave (pushimet në shtëpi); Ndalimi i transfereve të brendshme (mes institucioneve) të të burgosurve; Ndalimi i lëvizjeve jashtë institucioneve si vizitat humanitare, kontrollat mjekësore, përveç në rastet emergjente; Reduktimi apo ndalimi i përkohshëm i seancave gjyqësore për të paraburgosurit (në koordinim me gjykatat përkatëse); Drejtorët e institucioneve i rrisin masat e sigurisë sa i përket personelit shtesë, plotësimi me ekuipazh i kullave vrojtuese 24/7; Njësitë intervenuese në QK Dubravë, BSL dhe qendrat e tjera të jenë në gjendje gatishmërie; Njësia e përcjelljes së të burgosurve të jetë në gjendje gatishmërie 24 orë në ditë; Inicimi i procedurës për pezullimin e ekzekutimit të dënimit për të burgosurit me sëmundje të rënda; Dezinfectimi, kontrolli i brejtësve dhe dezinfektimi i të gjitha zonave të banimit dhe objekteve të burgjeve (kjo duhet të bëhet nga DDD; Stafit në praninë t’i sigurohen maska dhe doreza sterile; Ekzaminimi i vazhdueshëm i stafit nga mjekët në qendrat korrektuese/të paraburgimit (me pëlqimin e departamentit shëndetësor të burgjeve; Ekzaminimi i vazhdueshëm i të burgosurve/të paraburgosurve me simptoma të infektimit; Furnizimi i të burgosurve

PO u plotësua me masa shtesë të miratuara më 16 mars 2020, që mes të tjerash parashihnin obligimin që të gjithë të burgosurit që riktheheshin apo pranoheshin në institucione të vendoseshin në karantinë për shtatë ose 14 ditë. Më 6 prill 2020 dhe 10 tetor 2020 respektivisht, u miratuan urdhëra operacional për lehtësimin e kufizimeve, ndërsa më 4 nëntor 2020 u miratua një urdhër operacional i cili kishte për qëllim prapë shtimin e masave të sigurisë. Më 21 dhjetor 2021, SHKK nxori një plan operacional për lehtësimin e ndalesës së vizitave familjare dhe rifillimin e privilegjeve për pushime në fundjavë duke filluar nga 28 dhjetor 2020. Megjithatë, më 8 janar 2020, SHKK prapë nxori një ndalesë të përkohshme për ndalimin e pushimeve në fundjavë (pushimeve në shtëpi). Vizitat familjare u lejuan të vazhdonin, megjithatë lejohej vetëm nga një vizitor i moshës madhore njëkohësisht duke i respektuar masat mbrojtëse.

Më 22 shkurt 2021, SHKK nxorri një plan tjetër operacional për lehtësimin e kufizimeve në lidhje me vizitat familjare duke filluar nga 23 shkurt 2021, për t'i lejuar dy të rritur dhe dy fëmijë njëkohësisht për të vizituar të burgosurit duke i respektuar masat mbrojtëse gjatë asaj vizite.

Edhe pse në fillim SHKK hasi në vështirësi sa i përket furnizimit të gjitha institucioneve me numër të mjaftueshëm të maskave për shkak të procedurave të komplikuar të prokurimit dhe iu desh që të bazohej në donacione, SHKK arriti që shpejtë të bëhej furnizues vetanak duke i prodhuar maskat për nevoja të veta për të gjitha institucionet e SHKK në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, ku makinat e qepjes ishin aty që më parë.

Në përgjithësi, vërtetimet e drejtpërdrejta të EULEX-it sa i përket zbatimit të masave parandaluese në institucionet korrektuese kanë treguar për një nivel në përgjithësi të lartë të respektimit, si: matja e temperaturës tek hyrja e institucioneve, higjiena e shtuar, respektimi i përgjithshëm i udhëzimeve për distancimin fizik (kur ishte e mundur në ambiente të ndalimit), hapësira adekuate për karantinim dhe zbatimin rigoroz të tyre, disponueshmëria e dezinfektuesve, bartja e maskave nga shumica e stafit, lirimi nga detyra i stafit të kategorisë së rrezikuar dhe lirimi nga detyra i stafit të infektuar deri në marrjen e testeve negative për COVID-19.

Megjithatë, ka pasur disa raste kur monitoruesit e EULEX-it kanë vërejtur se, kryesisht për shkak të kushteve materiale të këqija, në veçanti nëpër institucione të vjetra, SHKK ka hasur në vështirësi për përmirësimin e kushteve higjienike pavarësisht përpjekjeve shtesë dhe distancimit fizik. Misioni, po ashtu, ka vërejtur se disa nga pjesëtarët e stafit që kanë punuar me të burgosurit nuk kanë bartur maska. Më tej, në disa raste, të burgosurit janë ankuar për zbatimin jorigoroz të masave mbrojtëse sa i përket COVID-19.

Deri në fund të marsit 2021, numri i stafit të SHKK të infektuar me COVID-19 që nga shpërthimi i pandemisë në mars 2020 ishte 223, ndërsa numri i të burgosurve të infektuar ishte 46, prej të cilëve katër kanë vdekur. Në përgjithësi, masat parandaluese të zbatuara nga autoritetet e Kosovës duket se kanë shpjerë në një numër relativisht të ulët të infektiveve të regjistruara në mesin e stafit të SHKK-së dhe të burgosurve.

Rekomandim:

- Drejtuesit e mesëm dhe të lartë të SHKK-së duhet t'i zbatojnë me rigorozitet masat parandaluese COVID-19 në të gjitha institucionet e SHKK, përfshirë përdorimin e duhur të mbulimit të fytyrës.

brenda burgjeve me materiale higjienike si shampon, sapun dhe pastrues të duarve; vlerësimi i rrezikut brenda burgjeve/qendrave të paraburgimit, identifikimi i personave të prirë për trazira apo për organizim të trazirave dhe përhapje të panikut; kontrollimi i rreptë i përgatitjes së ushqimit nga stafi i kuzhinës; kontrolli ditor i ushqimit nga stafi mjekësor.

Ndërprerja e vizitave familjare

Rëndësia e respektimit të dinjitetit njerëzor, si dhe parimet e ligjshmërisë, nevoja dhe proporcionaliteti i çfarëdo kufizimi të drejtave të burgosurve, janë të pasqyruara qartë në legjislacionin përkatës të Kosovës.²¹

PO i datës 11 mars 2020 ka paraparë ndalimin e të gjitha vizitave familjare në të gjitha institucionet, përfshirë në institucionet për femrat dhe të miturit, pa përjashtime prej datës 12 deri 27 mars 2020. Masa u bë publike më 12 mars 2020, përmes shpalljeve në faqen e internetit të SHKK në gjuhën shqipe, përmes Facebook (po ashtu vetëm në gjuhën shqipe) dhe përmes intervistave të dhëna nëpër media nga ana e drejtuesve të lartë të SHKK-së.²² Publikut nuk i janë dhënë informata në gjuhën serbe çka është në kundërshtim me ligjin e Kosovës. Si kompensim për ndalimin e kontakteve familjare me prani fizike, komunikimi përmes Skype filloi të zbatohet gradualisht në të gjitha institucionet korrektuese, në pajtueshmëri me deklaratën e parimeve të KPT, parimi 7²³.

Vizitat familjare dhe kalimi i kohës në lokale të veçanta²⁴ ka rifilluar më 1 qershor 2020 deri 11 korrik 2020 (me nga një anëtar të ngushtë të familjes njëkohësisht), pastaj ato u ndërprehen nga 11 korrik deri 24 gusht 2020, dhe prapë rifilluan prej 24 gusht dhe prapë u ndërprehen më 21 tetor 2020. Ato rifilluan më vonë më 28 dhjetor 2020 me nga një anëtar të familjes për çdo të burgosur dhe u lehtësuan më tej më 23 shkurt 2021, duke lejuar vizitat nga dy të rritur dhe dy fëmijë. Më 3 prill 2021, megjithatë, numri i vizitorëve u kufizua përsëri në vetëm një anëtarë të familjes së ngushtë për shkak të numrit në rritje të rasteve me COVID-19 në Kosovë, si dhe me

21 Kodi Penal (KP) kërkon që gjatë ekzekutimit të dënimit, personi i dënuar nuk i nënshtrohet trajtimit apo dënimit çnjerëzor apo degradues (Neni 88). Të drejtat e personit të dënuar respektohet gjithmonë dhe mund të kufizohen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (Neni 89). Këto standarde kërkojnë edhe me nenin 5 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), i cili parasheh që, sanksionet penale ekzekutohen në një mënyrë që sigurojnë humanitetin e trajtimit dhe respektimin e dinjitetit të çdo individi. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës apo trajtimit apo dënimit çnjerëzor apo degradues (par.1). Gjatë ekzekutimit të sanksionit penal, të drejtat e personit të dënuar respektohen gjithnjë dhe mund të kufizohen vetëm në masën e domosdoshme për ekzekutimin e sanksionit penal, në pajtim me ligjin e aplikueshëm dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (par. 4).

Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM), në nenin 4 par. 6 kërkon që, çdo i mitur i cili privohet nga liria trajtohet me humanitet për dinjitetin e qenësishëm të personit njeri, dhe në atë mënyrë që merr parasysh nevojat personale të moshës së tij. Standarde të ngjashme kërkojnë për të paraburgosurit. Sipas nenit 194 të Kodit të Procedurës Penale, i paraburgosurit duhet të trajtohet në mënyrë humane dhe shëndeti i tij apo saj fizik dhe mendor duhet të mbrohet.

22 [Shërbimi Korrektues i Kosovës \(rks.gov.net\)](https://rks.gov.net/); <https://kosovapress.com/bie-numri-i-te-burgosurve-dhe-paraburgosurve-shkak-pandemia/>; [https://president-ksgov.net/en/news/the-president-talks-with-the-heads-of-the-justice-institutions-to-prevent-the-spread-of-the-pandemic-in-prisons/presidenti bisedon me kreret e institucioneve te drejtises per parandalimin e perhapjes se pandemise ne burgje](https://president-ksgov.net/en/news/the-president-talks-with-the-heads-of-the-justice-institutions-to-prevent-the-spread-of-the-pandemic-in-prisons/presidenti-bisedon-me-kreret-e-institucioneve-te-drejtises-per-parandalimin-e-perhapjes-se-pandemise-ne-burgje); <https://frontonline.net/shkk-asnje-i-burgosur-nuk-eshte-prekur-me-covid-19/>; <https://gazetaobjektiv.com/te-henen-nis-zbatimi-i-masave-lehtesuese-ndaj-te-burgosurve/>; <https://zhurmapress.com/lajme/bie-per-100-numri-i-te-burgosurve/>; <https://telegrafi.com/gjate-pandemise-ka-rene-numri-te-burgosurve-te-arrestuarit-nuk-jane-testuar-per-covid-19/amp/>

23 Parimi 7: Ndonëse është legjitime dhe e arsyeshme të pezullohen veprimtaritë joesenciale, të drejtat themelore të personave të ndaluar gjatë pandemisë duhet të respektohen në plotësi. Kjo përfshinë në veçanti të drejtën për mbajtjen e higjienës personale të duhur (përfshirë qasjen në ujë të ngrohtë dhe sapun) dhe të drejtën për qasje të përditshme në hapësira të jashtme (për së paku një orë). Më tej, çdo kufizim i kontaktit me botën e jashtme, përfshirë vizitat, duhet të kompenzohen me qasje të shtuar në mënyra alternative të komunikimit (si telefon apo komunikim Voice-over-Internet-Protocol).

24 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 65: "Kalimi i kohës në lokale të veçanta": Personi i dënuar ka të drejtë të qëndrojë me bashkëshortin/en dhe fëmijët së paku një (1) herë në tre (3) muaj të paktën tri (3) orë. Para 2: Koha, kohëzgjatja, mënyra e vizitës, natyra e vizitave dhe kalimi i kohës në lokale të veçanta rregullohet me aktin për rendin shtëpiak.

qëllim të parandalimit të përhapjes së pandemisë dhe mbrojtjes së shëndetit të burgosurve dhe personelit në institucionet korrektuese.

E drejta e të burgosurve, si atyre të dënuar ashtu edhe të paraburgosurve, për mbajtjen e kontakteve kuptimplote me familjet e tyre të ngushta është e pranuar qartë nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si pjesë e të drejtës së çdo individi për privatësi dhe jetë familjare sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.²⁵ Kjo po ashtu është e kodifikuar fuqishëm në legjislacionin e Kosovës. Sipas Nenit 62 par.1 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), “*Personi i dënuar ka të drejtë për pranimin e vizitave së paku një herë në muaj në kohëzgjatje prej së paku një (1) orë nga bashkëshorti/ja, fëmija, fëmija i adoptuar, prindi, prindi adoptues dhe të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë, ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt.*”²⁶ Sipas Nenit 62 par.6 të LESP, çështjet në lidhje me procedurat, sigurinë dhe kushtet sipas të cilave vizitat mund të refuzohen ose suspendohen rregullohen me legjislacion sekondar. Përveç kësaj, personi i dënuar ka të drejtë të kalojë kohë në objekte të posaçme²⁷ me bashkëshortin/bashkëshorten së paku një herë çdo tre muaj për më së paku tri orë.²⁸

Personat e paraburgosur, po ashtu, kanë të drejtë për vizita familjare. Sipas nenit 200 të Kodit të Procedurës Penale, me lejen e gjyqtarit, i paraburgosuri mund të ketë vizita prej familjarëve të ngushtë. Megjithatë, vizitat mund të ndalohen nëse ato mund të jenë të dëmshme për zhvillimin e procedurës gjyqësore²⁹. Në rast të refuzimit nga ana e gjyqtarit, i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet pranë Panelit shqyrtues.

Sa i përket të miturve, në bazë të nenit 4 para. 6 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur (KDM), çdo i mitur ka të drejtë të mbajë kontakte me familjen e tij.³⁰ Në bazë të nenit 88 të KDM, i mituri ka të drejtë të pranojë vizitë nga familja së paku një herë në javë për së paku një orë. Ata po ashtu kanë të drejtë të pranojnë vizitë së paku një herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk do të kenë ndikim negativ mbi ekzekutimin e masës. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues ka autoritetin që të ndalojë vizita për shkaqe të arsyetuara në pajtim me aktin nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë.³¹ Sipas nenit 39 para. 9, të Udhëzimit Administrativ 07/2015 për

25 Për një pasqyrë të së drejtës dhe praktikës ndërkombëtare për këtë çështje shih: KHOROSHENKO v. RUSSIA [GC] no. [41418/04](#), § 58-84.

26 Neni 62 LESP, para 6: Çështjet lidhur me kontrollin e detajuar të vizitorëve të personave të dënuar, për sigurinë gjatë vizitave, për procedurat e kategorive specifike të vizitorëve dhe për kushtet sipas të cilave vizitat mund të refuzohen, ose të pezullohen nga drejtori i institucionit korrektues për shkaqe të mbrojtjes dhe sigurisë rregullohen me aktin për rendin shtëpiak. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8867>

27 Neni 65 LESP, para 1: Personi i dënuar ka të drejtë të qëndrojë me bashkëshortin/en dhe fëmijët së paku një (1) herë në tre (3) muaj të paktën tri (3) orë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8867>

28 Koha, kohëzgjatja, mënyra e vizitës, natyra e vizitave dhe kalimi i kohës në lokale të veçanta rregullohet me aktin për rendin shtëpiak.

29 Neni 200 KPP, para 1: Me leje të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues dhe nën mbikëqyrjen e tij ose nën mbikëqyrjen e ndonjë personi të caktuar nga gjyqtari i tillë, i paraburgosuri mund të vizitohet nga farefisi i afërm dhe me kërkesë të tij mund të vizitohet nga mjeku apo nga persona të tjerë, duke respektuar rregullat e institucionit të paraburgimit. Vizita të tilla mund të ndalohen nëse mund të dëmtojnë zbatimin e procedurës penale.

30 Neni 4 KDM: Çdo i mitur i privuar lirie trajtohet me humanizëm për hir të dinjitetit të personalitetit të tij njerëzor, dhe me atë rast merren parasysh nevojat personale të moshës së tij. Në veçanti, çdo i mitur i privuar lirie ndahet nga madhorët, përpos nëse konsiderohet se është në interes të miturit të mos ndahet, dhe gëzojnë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me familjen e tij përmes korrespondencave dhe vizitave, përveç rrethanave të jashtëzakonshme të përcaktuara me ligj.

31 Neni 88 KDM para 1. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në javë minimum deri në një (1) orë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt.

Rendin Shtëpiak në institucionet korrektuese (Rendi shtëpiak) ,³² nëse i dënuari apo vizitori e pengon disiplinën, sigurinë dhe mbrojtjen, zyrtari mbikëqyrës mund ta ndërpresë atë vizitë.

Prej datës 1 dhjetor 2020 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2020 i MeD për ndalimin e vizitave për shkaqe të arsyeshme. Sipas këtij Udhëzimi, Drejtori i institucionit Korrektues, në rast të epidemive në Kosovë, si dhe për ta parandaluar përhapjen e sëmundjes, përkohësisht mund t'i ndalojë të gjitha vizitat për të miturit në qendrat edukative përmirësuese të hapura dhe gjysëm të hapura.

Në Deklaratën e tij të parimeve në mars 2020, KPT theksoi se "[ç]do masë kufizuese e ndërmarrë kundrejt personave të privuar nga liria për parandalimin e përhapjes së COVID-19 duhet të ketë bazë ligjore dhe të jetë e domosdoshme, proporcionale, duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe të jetë e kufizuar në kohë. Personat e privuar nga liria duhet të marrin informata gjithëpërfshirëse rreth atyre masave në gjuhën që ata e kuptojnë". (Parimi 4)

Parimi 4 i deklaratës së KPT citon katër parime themelore që duhet t'i përmbushin masat kufizuese si ato për vizitat familjare: ligjshmëria, domosdoshmëria, proporcionaliteti dhe kohëzgjatja e kufizuar.

EULEX-i ka vërejtur se asnjë prej planeve apo urdhërave operacional që janë miratuar nuk përmendin bazën juridike mbi të cilën ato janë miratuar dhe nuk i referohen nenit 39 të UA/ Rendi shtëpiak³³ i cili parasheh se: "Në rast të sëmundjeve epidemike, Drejtori i institucionit korrektues mund t'i ndalojë përkohësisht të gjitha vizitat deri në marrjen e një vendimi final nga ana e Drejtorit të përgjithshëm të shërbimit korrektues. Personat e dënuar do të kenë mundësinë që t'i informojnë familjet e tyre për ndalimin e vizitave me shpenzime të institucionit korrektues (par.6)". "Në rast të ndonjë epidemie, do të aplikohen masat kundër epidemisë, dhe procesimi i kontakteve sipas rekomandimeve të grupit mjekësor profesional të themeluar nga Ministria e Shëndetësisë (par. 7)". Misioni më tej thekson se e drejta për vizitat familjare është e paraparë me ligj dhe se për përmbushjen e parimit të ligjshmërisë, kufizimi i tyre duhet të bazohet qartë në legjislacionin e Kosovës. Kjo po ashtu do të ishte e rëndësishme për të siguruar transparencë dhe siguri juridike.

Sa i përket aspekteve të domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit, derisa EULEX-i e pranon se autoritetet kanë bërë vlerësim të vazhdueshëm të situatës me qëllim të heqjes së masave sa më parë që ishte e mundur, Misioni thekson se me qëllim të respektimit të parimit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, një qasje specifike për secilin rast veç e veç duke e marrë parasysh situatën specifike në çdo institucion do të kishte qenë më e duhur, në veçanti pas periudhës së parë të mbylljes. Në të vërtetë, parimi i domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit kërkon që autoritetet të bëjnë vlerësim të vazhdueshëm të situatës për shkak të ndryshimit të rrethanave me kalimin e kohës dhe të miratojnë masa më pak kufizuese.

Parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit do të duhej të zbatoheshin në mënyrë edhe më rigoroze në rastet e të burgosurve të mitur, ndërsa autoritetet kanë zgjedhur aplikimin e

Para 2. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një (1) herë në muaj nga persona të tjerë të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.
Para 3. Drejtori i institucionit edukativo-korrektues ka autorizimin për të ndaluar vizitat për shkaqe të justifikueshme në pajtim me një akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Drejtësisë.

32 Ministria e Drejtësisë, Udhëzimi Administrativ MD -Nr.07/2015 për rendin shtëpiak në institucionet korrektuese, i nënshkruar nga Ministri i drejtësisë, data 14.07.2015, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10993>.

33 [Si më lartë.](#)

masave të njëjta edhe për institucionet ku ata janë të vendosur, pavarësisht faktit se të miturit kanë të drejtë për më shumë vizita në pajtim me ligjin.³⁴ Megjithatë, EULEX-i konsideron se ky nen duhet të interpretohet në tërësinë e tij, respektivisht e drejta për të ndaluar vizita të caktuara për të mitur të caktuar për shkaqe të arsyeshme, por jo si një autorizim për t'i ndaluar të gjitha vizitat për të gjithë të miturit. Në fund, për të burgosurat me fëmijë nuk janë paraparë aranzhime të posaçme.³⁵

Rekomandime:

- Të sigurohet bazë juridike e shëndoshë për kufizimet e të drejtave të të burgosurve;
- Të sigurohet shpërndarja e informatave në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës;
- Të aplikohen qasje për secilin rast veç e veç që i merr parasysh kushtet specifike të secilit institucion;
- Të mundësohen përjashtime dhe aranzhime të posaçme për kategori specifike të të burgosurve si të miturit dhe të burgosurat me fëmijë, si dhe për personat e cënueshëm (personat më të moshuar dhe personat me gjendje shëndetësore paraprake);
- Të sigurohet që kufizimet, masat dhe urdhërat/planet operationale t'i kenë parasysh çështjet gjinore dhe t'i përfshijnë çështjet gjinore;

Pezullimi i përkohshëm i punës jashtë institucioneve

Gjithnjë duke e patur parasysh rëndësinë e veprimtarive të punës jashtë institucioneve korrektuese për rehabilitimin e të burgosurve, këto veprimtari duhet të vlerësohen kundrejt rrezikut të përhapjes së virusit. Më 13 mars 2020, SHKK vendosi që të pezullojë privilegjin e punës së të burgosurve jashtë institucioneve të SHKK. Kjo praktikë kishte filluar si një privilegj i ri për të burgosurit për SHKK-në në vitin 2019 në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (QK SMRE). Pezullimi i këtij privilegji ishte masa e duhur për t'u ndërmarrë nga SHKK, meqë duhej marrë parasysh mbrojtja e përgjithshme e shëndetit dhe jetës së të gjithë të burgosurve dhe stafit në QK SMRE. Numri i vogël i të burgosurve që e kishin këtë privilegj do të kishte paraqitur rrezik të lartë për të tjerët për shkak se ata punonin në mesin e komunitetit dhe situata ishte duke u përkeqësuar.

Rekomandim:

- Të rikthehet privilegji i të burgosurve që të punojnë jashtë institucioneve korrektuese sa më parë që kjo të jetë e sigurtë.

Qasja e Avokatit të Popullit në institucionet korrektuese

Në pajtim me Deklaratën e Parimeve të KPT10 të miratuar në mars 2020,³⁶ autoritetet e Kosovës kanë garantuar gjithmonë qasjen e institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës në

34 Në bazë të nenit 4 para 6 dhe nenit 88 KDM, të miturit kanë të drejtë të kenë vizita për së paku një orë në javë kundrejt regjimit të rregullt të një ore në muaj për madhorët.

35 Neni. 62 para 4 LESP: Rregulla të veçanta vlejné për vizitat e nënave të dënuara nga fëmijët e tyre të cilat bëhen në baza më të rregullta.

36 Deklarata e parimeve e KPT 10: Monitorimi nga organet pavarura, përfshirë Mekanizmat nacional parandalues dhe KPT, vazhdon të jetë pararojë esenciale kundër keqtrajtimit. Shtetet duhet të vazhdojnë të garantojnë qasjen e organeve monitoruese në të gjitha vendet e ndalimit, përfshirë në vendet ku personat mbahen në karantinë. Të gjitha organet monitoruese megjithatë duhet të bëjnë kujdes të madh për respektimin e parimit 'mos bë dëm', në veçanti me personat më të moshuar dhe personat me gjendje mjekësore paraprake.

institucionet e SHKK. Institucioni i Avokatit të Popullit e luan rolin themelor të mekanizmit nacional parandalues. Mekanizmi nacional parandalues i ka ndërprerë të gjitha vizitat në terren në institucionet korrektuese (dhe në institucionet e tjera që i inspektojnë) në mesin e muajit mars 2020 me qëllim të minimizimit të rrezikut të përhapjes së infektiveve me COVID-19 dhe i rifilloi vizitat e tyre ad-hoc nëpër institucionet korrektuese në shtator 2020.

Rekomandim:

- Avokati i Popullit duhet të vazhdojë ta shfrytëzojë të drejtën e tij për kryerjen e vizitave në institucionet e SHKK kurdo që një gjë e tillë të jetë e sigurtë, me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij themelore për parandalimin e torturës dhe keqtrajttimeve të tjera në institucionet korrektuese.

Qasja e avokatëve në institucionet korrektuese

Qasja fizike e avokatëve në të gjitha institucionet korrektuese të Kosovës është ndaluar nga 12 mars deri 20 maj 2020. Kjo qasje është pezulluar prapë prej datës 21 tetor 2020, me përjashtim të avokatëve mbrojtës të rasteve gjykimet e të cilave mbaheshin.

Neni 61 (2) i KPP garanton të drejtën e të pandehurit/personit të privuar nga liria që të komunikojë me avokatin e tij mbrojtës gojarisht dhe me shkrim në kushte që e garantojnë konfidencialitetin.³⁷

Përveç të drejtës për të komunikuar me avokatët mbrojtës, neni 61 i LESP parasheh që *“institucioni korrektues ia lehtëson personit të dënuar qasjen në ndihmë juridike në lidhje me ekzekutimin e dënimit me burgim apo burgim të përjetshëm dhe ndërmerr masa të nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të garantuara me ligj. Personi i dënuar po ashtu ka të drejtë të vizitohet prej përfaqësuesit të autorizuar i cili e përfaqëson atë në procedurat ligjore”*.³⁸

Përfaqësuesit e Shoqatës së Avokatëve të Kosovës gjithashtu kanë ngritur shqetësime për sa i përket qasjes së penguar të avokatëve mbrojtës tek klientët e tyre të burgosur, në veçanti në rastet urgjente, si seancat për caktimin e paraburgimit, kur janë nevojitur veprime juridike dhe konsultime ligjore të menjëhershme. Avokatët, po ashtu, kanë ngritur shqetësime për kontrollet trupore të zgjeruara të avokatëve në institucionet korrektuese, biles edhe gjatë periudhës së pandemisë, çka ka shkaktuar vonesa dhe e ka kufizuar kohën që ata do ta kalonin me klientët e tyre në institucionet e burgjeve. Këto çështje mund ta pengojnë efektivitetin e mbrojtjes penale dhe të drejtat e të burgosurve për të pasur qasje në avokat.

Rekomandime:

- Të bëhet një shqyrtim i asaj se si të drejtat e të pandehurit/personit të privuar nga liria për të komunikuar me avokatin mbrojtës gojarisht apo me shkrim në kushte që garantojnë konfidencialitetin mund të respektohen dhe të mbrohen pa pengesë, në lidhje me pengesat e shtuara nga pandemia.
- Të bëhen konsultime me ekspertë juridik dhe organe zyrtare përkatëse para zbatimit të çfarëdo mase që mund t'i kufizojë këto të drejta.

37 Neni 61, para 2 KPP: Avokati ka të drejtë të komunikojë lirshëm me të pandehurin gojarisht dhe me shkrim në kushte që garantojnë konfidencialitetin.

38 Neni 63, para 1 LESP: Personi i dënuar mund të vizitohet nga përfaqësuesi i tij/saj i autorizuar i cili e përfaqëson atë në procedurat ligjore.

Lirimi i të burgosurve të cenueshëm nga institucionet korrektuese

Deklarata e Parimeve e KPT, Parimi nr. 5, thekson: “Meqë kontakti personal i afërt inkurajon përhapjen e virusit, përpjekje të orkestruara duhet të ndërmerren nga të gjitha autoritetet përkatëse për zgjedhjen e alternativave të privimit të lirisë. Kjo qasje është obligative, në veçanti, në situata të mbipopullimit. Më tej, autoritetet duhet të shfrytëzojnë më shumë alternativat e paraburgimeve në procedura paraprake, zëvendësimin të dënimeve me burgim, lirimit të hershëm dhe sprovimit; të rivlerësojnë nevojën për vazhdimin e vendosjes pa dëshirë të pacientëve psikiatrik; lirimin për kujdes për komunitetin, kurdo që është mundur, të banorëve të shtëpive të kujdesit social; dhe të heqin dorë, në masën më të madhe që është e mundur, nga paraburgimi i migrantëve”.

Nënkomisioni i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës, Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor apo Degradues dhe Aleanca për Mbrojtjen e Fëmijës në Veprim Humanitar kanë bërë apel për masa për zvogëlimin e numrit të personave në institucione edukativo/korrektuese për shkak të cenueshmërisë së të burgosurve gjatë pandemive.³⁹

Mbipopullimi nuk është problem për momentin në burgjet e Kosovës⁴⁰ andaj ndryshe prej shumë vendeve evropiane, në Kosovë nuk ka pasur nevojë të madhe për uljen e numrit të të burgosurve me qëllim të ndalimit të përhapjes së virusit.

Një gjë tjetër relevante për t’u theksuar është se në Kosovë numri i të burgosurve është ulur për 20,3% nga data 12 mars, kur SHKK filloi zbatimin e masave kufizuese, deri në fund të dhjetorit 2020, ku numri i përgjithshëm në burgje shkoi nga 1755 në 1398 (1014 të dënuar dhe 384 të paraburgosur). Vonesat në seancat dëgjimore dhe në shqiptimin e dënimeve nëpër gjykime mund të jetë një prej shpjegimeve për zvogëlimin e numrit të të burgosurve. Në mesin e marsit, numri i grave të dënuara dhe në paraburgim ishte 42, ndërsa deri në fund të dhjetorit 2020 ky numër ra në 35. Gjatë kësaj periudhe edhe numri i të paraburgosurve të mitur u ul nga 44 në 39.

Pavarësisht asaj që u tha më lartë, fakti se korniza juridike nuk e mundëson shtyrjen, pezullimin apo ndërprerjen e dënimeve për shkak të arsyeve të ndërlidhura me pandeminë⁴¹, kjo mbetet çështje e cila meriton vëmendje nga fakti se rreziqet e infektimit me COVID-19 në institucionet korrektuese janë më të larta dhe se gjendjet shëndetësore paraprake apo mungesa e imunitetit tek të burgosurit e caktuar mund të shpiejnë në simptoma më të rënda.

Rekomandim:

- Autoritetet duhet ta shqyrtojnë miratimin e legjislacionit që e mundëson, kur kjo gjë është e sigurt, shtyrjen, pezullimin apo ndërprerjen e dënimeve për arsye të ndërlidhura me pandeminë, në veçanti për grupet e cenueshme siç janë të miturit dhe individët e rrezikuar nga zhvillimi i simptomave të rënda të COVID-19.

39 <https://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/AdviceStatePartiesCoronavirusPandemic2020.pdf>; <https://rm.coe.int/16809cfa4b> and <https://rm.coe.int/16809ef566>; <https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Detention/ChildrenDeprivedofLibertyandCOVID.pdf>

40 Më 30 shtator 2020, kapaciteti i përgjithshëm zyrtar i SHKK i raportuar nga SHKK ishte 2502, ndërsa numri i të burgosurve në total ishte 1522, me 991 shtretër të zbrazët.

41 Shtyrja (Neni 20 i LESP dhe Neni 82 i KDM); Pezullimi (Neni 94 i ndryshuar i LESP dhe Neni 83 i KDM); Lirimi me kusht (Neni 90 i KP, Neni 121 i LESP and Neni 36 i KDM); Lirimi i parakohshëm (Neni 127 i ndryshuar i LESS).

SHTOJCË – REKOMANDIME

SISTEMI I DREJTËSISË:

1. Qasja e miratuar nga KGJK për identifikimin e një numri të veprimtarive specifike të vlerësuara si 'urgjente' por, që në të njëjtën kohë, gjyqtarëve ua lë një shkallë të diskrecionit për përcaktimin e veprimtarive të tjera urgjente është për t'u përgëzuar. EULEX-i i inkurajon gjykatat që ta përdorin këtë diskrecion me maturi dhe në pajtim me standardet për të drejtat e njeriut, në mënyrë që të prioritizohen aktivitetet të cilat, nëse do të neglizhoheshin, do të shkaktonin dëme të pariparueshme, në veçanti ndaj individëve apo grupeve të cënueshme;
2. Me qëllim të sigurimit të respektimit të parimit të 'publicitetit', gjykatat duhet të vazhdojnë të sigurojnë objekte të përshtatshme për praninë e publikut të interesuar. Derisa masat për kufizimin e numrit të personave që fizikisht janë të pranishëm në sallë të gjykimit mund të vlerësohen të domosdoshme dhe proporcionale për parandalimin e përhapjes së virusit, është e rëndësishme që këto dispozita të mos interpretohen në atë mënyrë që për të gjitha arsyet praktike të ndalojnë publicitetin e gjykimeve;
3. Kryetarët e gjykatave dhe gjyqtarët duhet të bëjnë aranzhime dhe të bëjnë plane më të mira paraprake për shfrytëzimin sa më të mirë të objekteve të gjykatave dhe sallave të gjykimeve, në veçanti për shmangien e përdorimit të sallave të vogla për gjykime me numër të madh të pjesëmarrësve dhe përdorimit të sallave të mëdha për gjykime me më pak pjesëmarrës;
4. Kryetarët e trupave gjykues duhet të sigurojnë në mënyrë proaktive që publiku të lejohet të vijojë seanca dëgjimore dhe njëkohësisht të sigurojnë respektimin e distancës fizike dhe të masave mbrojtëse;
5. Nëse paraqitet nevoja për kufizimin e pranisë së publikut nëpër sallat e gjykimit, duke i pasur parasysh kufizimet COVID-19, kryetarët e trupave gjykues megjithatë duhet të sigurojnë që pjesëtarët e publikut që dëshirojnë të marrin pjesë në seanca dëgjimore në cilësinë private të tyre të mos ndalohen në mënyrë automatike;
6. Gjyqtarët dhe stafi i gjykatave duhet të kërkojnë dhe të sigurojnë përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës fizike, në veçanti brenda sallave të gjykimit;
7. Sallat e gjykimit duhet të ajroren shpesh;
8. Shenjat për masat mbrojtëse duhet të jenë të dukshme dhe dezinfektuesit e duarve të jenë gjithmonë në dispozicion brenda objekteve të gjykatave;
9. Caktimi i sallave duhet të bëhet sipas numrit të personave që priten të jenë të pranishëm në gjykime (të pandehurit, avokatët, dëshmitarët, palët e dëmtuara, publiku, etj.);

10. Stafi i gjykatës duhet t'i informojë palët dhe publikun në mënyrë proaktive për kohën e pritshme të fillimit të seancave dhe të parandalojnë qasjen nëpër zonat e pritjes deri në fillimin e seancave dhe/apo praninë e panevojshme në objektet e gjykatave;
11. Përdorimi i VTC duhet të rregullohet në mënyrën e duhur me ligj;
12. Ndonëse nuk është e parashikuar në mënyrë specifike në KPP, prania e publikut po ashtu mund të sigurohet përmes mjeteve teknologjike. Kjo mund të zbatohet përmes dhënies së vegzës/linkut për video për publikun dhe mediat, apo përmes sigurimit të monitorëve televiziv në hapësira të ndara në salla të gjykimit. Në mungesë të një rregulloreje konkrete për këtë çështje, është e këshillueshme që kjo çështje të rregullohet me ligj;
13. Çështja e “rregullit të tre muajve” duhet të rregullohet urgjentisht me ligj me qëllim të sigurimit të sigurisë juridike. Vlen të theksohet se drafti aktual i KPP parasheh se në vend të tre muajve, do të duhet të kalojnë gjashtë muaj mes dy seancave dëgjimore para rifillimit të gjykimit. Me rëndësi, ai po ashtu e lejon në mënyrë specifike vlerësimin e dëshmimeve si të lexuara pas kalimit të këtyre gjashtë muajve çka do të kontribuonte në siguri juridike të shtuar.

SISTEMI KORREKTUES

1. Menaxhmenti i mesëm dhe i lartë i SHKK duhet t'i zbatojnë me rigorozitet masat parandaluese COVID-19 në të gjitha institucionet e SHKK, përfshirë përdorimin e duhur të mbulimit të fytyrës;
2. Të sigurohet bazë juridike e shëndoshë për kufizimet e të drejtave të burgosurve;
3. Të sigurohet shpërndarja e informatave në të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës;
4. Të aplikohen qasje për secilin rast veç e veç, e cila i merr parasysh kushtet specifike të secilit institucion;
5. Të mundësohen përjashtime dhe aranzhime të posaçme për kategori specifike të të burgosurve si të miturit dhe të burgosurat me fëmijë, si dhe për personat e cenueshëm (personat më të moshuar dhe personat me gjendje shëndetësore paraprake);
6. Të sigurohet që kufizimet, masat dhe urdhërat/planet operationale t'i kenë parasysh aspektet gjinore dhe t'i përfshijnë aspektet gjinore;
7. Të rikthehet privilegji i të burgosurve që të punojnë jashtë institucioneve korrektuese sa më parë që kjo të jetë e sigurtë;
8. Avokati i Popullit duhet të vazhdojë të shfrytëzojë të drejtën e tij për kryerjen e vizitave në institucionet e SHKK kurdo që një gjë e tillë të jetë e sigurtë, me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij themelore për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit të tjera në institucionet korrektuese;
9. Të bëhet një shqyrtim i asaj se si të drejtat e të pandehurit/personit të privuar nga liria për të komunikuar me avokatin mbrojtës gojarisht apo me shkrim në kushte që garantojnë konfidencialitetin mund të respektohen dhe të mbrohen pa pengesë, në lidhje me pengesat e shtuara nga pandemia;
10. Të bëhen konsultime me ekspertë juridik dhe organe zyrtare përkatëse para zbatimit të çfarëdo mase që mund t'i kufizojë këto të drejta;
11. Autoritetet duhet ta shqyrtojnë miratimin e legjislacionit që e mundëson, kur kjo gjë është e sigurtë, shtyrjen, pezullimin apo ndërprerjen e dënimeve për arsye të ndërlidhura me pandeminë, në veçanti për grupet e cenueshme siç janë të miturit dhe individët e rrezikuar nga zhvillimi i simptomave të rënda të COVID-19.

